



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Data/Datum/Date:	27. 11. 2025
Nr./Br./No	05/1054
Për/Za/To:	Njësia për Burime Njerëzore
Nga/Od/From:	Për Yllka Fejzullahu, drejtoreshë e DKA-së
Lënda/Predmet/Subject :	NJFOTIM PËR MOSREALIZIM TË PROCEDURAVE TË KONKURSIT

Me anë të kësaj shkrese ju njoftojmë se lidhur me konkursin për pozitën Psikolog/e në IP “Albiona Asllani” në Shtime, referenca e rekrutimit 02-111/01-0026153/25, data 07.10.2025, protokoll 05/928 procedurat e rekrutimit ndërpriten dhe nuk do të vazhdojnë.

Ndërprerja e procedurave të rekrutimit për pozitën Psikolog/e, me numër reference 02-111/01-0026153/25, bëhet në pajtim me kërkesat dhe obligimet e përcaktuara në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të stafit në institucionet publike edukativo-arsimore parauniversitare. Sipas Nenit 1 (Qëllimi) dhe Nenit 2 (Fushëveprimi) të kësaj rregulloreje, të gjitha institucionet publike të arsimit parauniversitar janë të obliguara të zbatojnë procedurat, kriteret dhe afatet që rregullorja përcakton për procesin e rekrutimit. Në këtë rast, gjatë administrimit të procedurës nuk janë respektuar afatet e përcaktuara, gjë që përbën shkelje të drejtpërdrejtë të kërkesave të rregullores. Po ashtu, sipas Nenit 34 (Udhëzuesi për administrimin e procedurës së përzgjedhjes), çdo fazë e procesit të rekrutimit duhet të kryhet në përputhje me udhëzuesin zbatues dhe standardet procedurale. Devijimi nga këto standarde përfshirë mosrespektimin e afateve e bën procesin të pavlefshëm, pasi cenon ligjshmërinë e administrimit të konkursit.

Në bazë të Nenit 35 (Mbikëqyrja e zbatimit), organet përgjegjëse janë të detyruara të ndërmarrin masa korrigjuese në rast të mangësive procedurale, përfshirë ndërprerjen e procesit të përzgjedhjes, kur konstatohet mosrespektim i rregullores. Për shkak të këtyre shkeljeve procedurale konkretisht mosrespektimit të afateve të përcaktuara me QRK Nr. 19/2024 procedura e rekrutimit konsiderohet e pasuksesshme dhe nuk mund të vazhdohet me hapat e mëtejshëm.